

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë)
Titulli i lëndës:	Hulumtimet në edukimin matematikor
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (Sem III)
Numri i orëve në javë:	3+0 (3 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E hënë, 14.00 – 16.15
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Eda Vula
Detajet kontaktuese:	eda.vula@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Fokus kryesor i këtij kursi është shqyrtimi i hulumtimeve në fushën e edukimit matematikor dhe diskutimi i implikimeve në çështjet që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit e matematikës. Nga kjo bazë, studentët do të identifikojnë metodat e hulumtimeve në edukimin matematik, do të analizojnë rezultatet e hulumtimeve, formulojnë pyetje kërkimore dhe zhvillojnë planin e tyre të hulumtimit duke u bazuar në shqyrtim të literaturës përkatëse. Ndërkaq, aktivitetet individuale dhe ato bashkëpunuese do të mundësojnë analizimin e lidhjeve mes hulumtimeve në edukimin matematikor dhe praktikave mësimore me synim të përmirësimit dhe avancimit të proceseve të mësimdhënies dhe të nxënit të matematikës.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është aftësimi i studentëve për të lexuar në mënyrë ‘kritike’ dhe për të analizuar hulumtimet në fushën e edukimit matematikor. Planifikimi hapave të një hulumtimit. dhe shqyrtimi i thellë i literaturës do të jetë pjesë e rëndësishme e kursit, që synon t’i bëjë studentët të shfrytëzojnë reflektimet për rezultatet e hulumtimeve shkencore gjatë planifikimeve të aktiviteteve në kuadër të kursit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë problemet e hulumtimit në fushën e edukimit matematikor; • analizojnë hulumtimet në fushën e edukimit matematikor duke përfshirë shqyrtimin e literaturës, metodat e hulumtimeve dhe analizën e interpretimin e rezultateve;

	<ul style="list-style-type: none"> • analizojnë në mënyrë kritike studime të ndryshme për të identifikuar anët e forta dhe mangësitë konceptuale dhe metodologjike; • planifikojnë hapat e hulumtimit, • zhvillojnë pilot projekte për hulumtime në fushën e edukimit matematikor 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	12	24
Përgaditja përfundimtare për prezantim të projektit	4	3	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Te tjera: Lexim i artikujve për diskutim	2	10	20
Totali 25x5 = 125 orë			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Ligjërata interaktive, diskutime,reflektime individuale dhe punë në grupe në projektet hulumtuese.</i>		
Metodat e vlerësimit:			
Pjesëmarrja dhe diskutimet në klasë 10%			
Diskutimi i literaturës së lexuar 10%			
Analiza kritike e artikujve të publikuar në revista shkencore 30%			
Projekti hulumtues 50%			
Nota përfundimtare:			
Pikët(%)	Nota		
92-100	10		
82- 90	9		
70 -80	8		
60-69	7		
50-59	6		
Literatura			
Literatura bazë:	1.Jane Lo, J; Leatham, K. and Van Zoest, L,(Ed.) (2014). Research trends in mathematics teacher education. Springer;		
	2.Bikner-Ahsbahs, A., Knipping, C., & Presmeg, N. (Ed). (2015). <i>Approaches to Qualitative Research in</i>		

	<p><i>Mathematics Education. Examples of Methodology and Methods. Cham.Sprnger.</i></p> <p>3. Stylianides, G., & Hino, K. (2018). <i>Research advances in the mathematical education of pre-service elementary teachers. Cham: Springer.</i></p>
Literatura shtesë:	<p>2. Journal for research in mathematics education http://www.nctm.org/publications/journal-for-research-in-mathematics-education/</p> <p>3. Mathematics Education Research Journal https://www.springer.com/journal/13394</p> <p>Shënim: Literatura plotësuese (Metodat e hulumtimit në edukim) për realizimin e detyrave</p>

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i kursit. Syllabusi dhe detyrat
<i>Java e dytë:</i>	Historiku i hulumtimeve në fushën e edukimit matematikor
<i>Java e tretë:</i>	Qëllimi dhe metodat e hulumtimeve në edukimin matematikor
<i>Java e katërt:</i>	Perspektivat teorike në HEM
<i>Java e pestë:</i>	Qasja sasiore në hulumtimet e edukimit matematikor
<i>Java e gjashtë:</i>	Qasja cilësore në hulumtimet e edukimit matematikor
<i>Java e shtatë:</i>	Metodat e përziera në hulumtimet e edukimit matematikor
<i>Java e tetë:</i>	Problemet hulumtuese – praktikë e drejtuar
<i>Java e nëntë:</i>	Studimet krahasuese në edukimin matematikor
<i>Java e dhjetë:</i>	Hartimi i pyetjeve kërkimore dhe dizajni i hulumtimit – praktikë e drejtuar
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mësimdhënësi – hulumtues. Planifikimi i mësimdhënies bazuar në hulumtime
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Shfrytëzimi i hartës së koncepteve në klasat hulumtuese
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Kryerja e eksperimenteve të mësimdhënies në bashkëpunim me mësimdhënësit
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Prezantimet e projekteve hulumtuese
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimet e projekteve hulumtues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Çdo student duhet të:

- Viojë me rregull ligjëratat;
- Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera;
- Përgatitë dhe dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonesë do të ndëshkohet me pikë të humbura;
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit)
- Nuk lejohet kopjimi dhe gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye;
- Në provimin përfundimtar kanë të drejtë të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjëratat dhe ushtrimet dhe që kanë kryer detyrat gjatë kursit;
- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 115 i Statutit të UP-së).